



KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo Marrveshje Bashkëpunimi (referuar më poshtë si Marrveshja) nënshkruhet sot ,
më datë 01.04.2018 ndërmjet:

Kolegji Universitar 'REALD' VLORE person juridik me vendimin e Qendrës
Kombëtare Të Rregjistrimeve nr.K86607207N, datë 07.04.2008, me seli Lagjia
"Bashkimi" pranë Stacionit të Trenit, Vlorë përfaqësuar nga
Z. Serrik Muskoj në cilësinë e
Kryetarit të Bordit Administrativ

dhe

Qender Rehabilitimi "FIZIO LIFE" regjistruar në Qendren Kombëtare të
Regjistrimit me datë 28.06.2017 , me nr. Nipti L76828203A, me administrator/e
Luisiana Memushaj , me adresë, Vlore , Rruga Rrushit Gurishova , Lagjia Uji i
Ftohte, Objekt Nr 5, Kati i 1

Të dy referuar si palët, duke vlerësuar rëndësinë e edukimit, shkëmbimit të
praktikave dhe zhvillimit shkencor, dëshirojmë të ngrejmë një bashkëpunim të
frutshëm akademik.

Që tani e tutje, duke pasur në konsideratë bashkëpunimin, kushtet, afatet, palët
bien dakort si më poshtë:





KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është të përkrahë bashkëpunimin profesional e shkencor për interes e edukimit akademik, ushtrimit të praktikave, trajnimit dhe kërkimeve shkencore. Për këtë qëllim, bashkëpunimi do të konsistojë në:

- Lejimin pranë klinikes " FIZIO LIFE " ,Vlore të studentëve që frekuentojnë programin e studimit bachelor dhe Master Profesional 1-vjecar në Fizioterapi, në Kolegjin Universitar Reald" për ushtrimin e praktikave mësimore gjatë të katërta viteve akademike në funksion të programit të studimit.
- Ftesa të ndërsjellta të personelit akademik, të stafit mjekësor dhe studimeve për leksione, konfereca, takime shkencore.
- Shkëmbime kulturore dhe shkencore.
- Shkëmbime të stafit akademik e mjekësor për të plotësuar praktikat profesionale nga secili institucion.
- Shkëmbime informacioni të nevojshme për aktivitetet mësimore dhe shkencor

Neni 2

Obligime të përgjithshme

Palët marrin përsipër të :

- dokumente, material pedagogjike dhe kërkimore.
- Të organizojnë në bashkëpunim leksione, seminare, sipoziume.
- Të bëjnë aktivitet të tjera bashkëpunimi të rënë dakort nga të dyja palët



KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

Neni 3

Fusha e bashkëpunimit

Bashkëpunimi do të zhvillohet në fusha të përbashkëta nga të dyja palët në lidhje me programet mësimore e kërkimore që do të ofrohen nga Kolegji Universitar "Reald".

Neni 4

Praktika/Programe specifike

~~Për çdo bashkëpunim në lidhje me ushtrimin e praktikave mësimore nga ana e studentëve të programit 3-vjecare dhe master në Fizioterapi në Mjekësi, të Kolegjit Universitar "Reald" do të firmoset një protokoll. Protokollin duhet të mbajë informacionin e mëposhtëm:~~

1. Origjinën, natyrën dhe përshkrimin e praktikës mësimore.
2. Emrat e personave përgjegjës të angazhuar për dhënien e praktikës dhe studentët e KUR pjesëmarrës në praktikë.
3. Kohëzgjatjen e praktikës
4. Burimet financiare që do të duhen për të mbuluar shpenzimet e lidhura me praktikën.
5. Njohjen dhe vlefshmërinë e programeve të praktikës.

Neni 5



KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

Bashkëpunime të mëtejshme

Vazhdimësia e bashkëpunimit do të jetë objekt i marrëveshjeve të formuluara në bashkëpunim dhe të paraqitura pranë autoriteteve drejtuese të palëve. Kjo fazë e bashkëpunimit do të paraqitet tek organet drejtuese të palëve për aprovim.

Neni 6

Suporti financiar/Fondet

Kolegji Universitar "Reald" do të sigurojë me mjetet e tij, mbështetjen e nevojshme financiare për të përmbushur qellimet e kësaj marrëveshjeje. Mbështetja financiare do të mund të sigurohet edhe për vazhdimësinë e bashkëpunimit për programe të caktuara.

Neni 7

Suporti institucional

Secila palë do të ngrëjë një njësi monitorimi që do të garantojë zhvillimin dhe vazhdimësinë e kësaj Marrëveshjeje.



KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

Neni 8

Përgjegjësia

Asnjë nga palët nuk duhet të jetë përgjegjëse për mosrealizimin e detyrimeve respektive të parashikuara në këtë Marrëveshje, nëse këto mosrealizime janë shkaktuar nga zjarri, eksplozioni, uji, akte të natyrës, trazira civile, tërmete, greva, vandalizma, luftë, sabotime. Asnjë nga palët nuk do të jetë përgjegjëse për vlerën e pronave reale ose personale të shkatëruara nga shkaqet e sipërpërmendura.

Neni 9

Kohëzagjatja

Marrëveshja prezente është e vlefshme për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e firmosjes së saj nga palët. Në përfundim të kësaj periudhe, marrëveshja mund të rinovohet duke marrë në konsideratë rezultatet e regjistruara, dhe pasi ti kenë komunikuar autoriteteve përgjegjëse. Kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë, nga secila palë, duke njoftuar palën tjetër 6 (gjashtë) muaj përpara me shkrim.



KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

Neni 10


Dispozita të fundit

Të dyja institucionet duhet të ruajnë konfidencialitetin përsa i përket institucioneve ose individëve që nuk janë përfshirë në këtë marrëveshje, deri sa informacioni i marrë së bashku është publikuar.

Palët

Kolegji Universitar "REALD"

Serrate Muska
[Signature]



Administratori

Luisiana Memushaj

[Signature]